



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE P. - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:060379

Datë: 27.05.2022

Numri i dokumentit: 03064100

PPP.nr.75/2020

GJYKATA THEMELORE NË P.- DEGA ISTOG, si përmbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit KUR H.D SH.A me seli në P., kundër debitorit S. B.-N. H. P. D. Rr. nr.. Istog, për shkak të borxhit në shumë prej 1,089.18 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt. 19.08.2020 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt.27.05.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit: S. B.-N. H. P. D. Rr. nr.. Istog, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.601/2020 të dt.16.03.2020 për shkak të borxhit në shumë prej 1,089.18 €, si i PA AFATSHËM.

A r s y e t i m

Kreditori, KUR H.D SH.A me seli në P., ka ushtruar propozimin për përmbarim të përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorit S. B.-N. H. P. D. Rr. nr.. Istog, si në shkresat e lëndës, për borxh në shumë prej 1,089.18 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga pranimi i urdhrit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare të debitorit, sekuestrimi regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, e shuma e mjeteve të transferohet në llogari të kreditorit, të gjitha të specifikua në propozimin për përmbarim të datës 13.03.2020

Përmbaruesi privat me urdhrin P.nr.601/2020 të dt.16.03.2020 e ka lejuar propozimin për përmbarim.

Pas lejimit të përmbarimit me urdhër përmbarimor, të njëjtin përmbaruesi privat ja ka dorëzuar debitorit të cilin e ka pranuar me datë 10.08.2020 me paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejt të paraqes prapsim në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit.

Debitori, S. B.-N. H. P. D. Rr. nr.. Istog, ka ushtruar prapsim me dt: 19.08.2020 kundër urdhrimit për përmbarim P.nr.601/2020 të dt.16.03.2020, me te cilën është lejuar përmbarim sipas propozimit të kreditorit KUR H.D SH.A me seli në P..

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapsimit kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbarimit, andaj gjykata, bazuar në nenin 70 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore i cili thotë citoi “Prapësimi duhet të paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrimit përmbarues” e në rastin konkret debitori S. B.-N. H. P. D. Rr. nr.. Istog e ka pranuar propozimin për përmbarim të lejuar me urdhër me datë 10.08.2020 dhe afati ka filluar të ecë nga data 11.08.2020 ndërsa prapësimin e ka parashtruar me datë 19.08.2020, e nga pranimi i propozimit të përmbarimit e deri me ditën e paraqitjes së prapësimimit kanë kaluar 9 ditë, në rastin konkret afati i fundit për ngritjen e prapësimimit ka qenë data 17.08.2020, ashtu që prapësimi i debitorit konsiderohet si I PA AFATSHËM.

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 70, 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË P.- DEGA ISTOG
PPP.nr.75/2020, dt.27.05.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.